



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 4 prot.

Kamëz, më 26 .1.2026

V E N D I M
Nr. 4 .Datë 26 / 1 / 2026
M B I

“MIRATIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE GJATË VITIT 2026 PËR FAMILJET QË NUK JANË PËRFITUESE NGA SISTEMI I PIKËZIMIT, TË CILAT DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DUKE PËRDORUR DERI NË 6% NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE” DHE “TRAJTIMIN ME NDIHMË EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË NGA BUXHET I BASHKISË KAMËZ PËR VITIN 2026”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 26.1.2026, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.03 Datë 20.1.2026 në mbështetje të nenit 24 të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr.57 datë. 18/07/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë neni 21, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.597 datë. 04/09/2019 kreu 4 pika 3, për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, vendimit nr.617 datë 22.09.2022, vendimin 855, datë 26.12.2024 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 597 datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" neni 4, neni 5, neni 6 të Ligjit nr. 121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë" si dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz nr. 90 datë 17.12.2025 "Mbi miratimin e Projekt-Buxhetit afat mesëm të Bashkisë Kamëz (PBA)" për vitin 2026, 2027, 2028, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e kriterëve për dhënie e ndihmës ekonomike për familjet që nuk janë përfituese nga sistemi i pikëzimit të cilat do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6 % nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike", si dhe trajtimin me ndihmë ekonomike të nga buxheti i bashkisë, vijon si më poshtë;
 - a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;
 - b) jetimët, të cilët nuk janë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
 - c) prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë;
 - d) ç). viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre;
 - e) viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Familjet e sipërcituara do të verifikohen për situatën ekonomike nga administratorët shoqëror të ndihmës ekonomike dhe masa e ndihmës ekonomike për familjet përfituese do të llogaritet në të njëjtën mënyrë sipas përlllogaritjes së masës së strukturës së familjes, për familjet përfituese të ndihmës ekonomike, bazuar gjithashtu në fondin e vënë në dispozicion.
Kohëzgjatja e qendrimit në skemë do të jetë e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI

